

## VENDIM

(Qarkullues)

**Nr. 15, Datë 27.11.2013**

### **MBI DISA MODALITETE PËR ZHVILLIMIN E ZGJEDHJEVE TË PJESSHME TË DATËS 20.12.2013 NË FAKULTETIN E ARTEVE TË BUKURA TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

Senati i Universitetit të Arteve në datën 27.11.2013, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur, me qëllim zhvillimin e rregullt të zgjedhjeve të pjesshme në Fakultetin e Arteve të Bukura, për zgjedhjen e Përgjegjësve të Njësive Bazë në këtë Fakultet,

## VENDOSI

1. Procesi zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme të datës 20 dhjetor 2013 në Fakultetin e Arteve të Bukura konsiderohet se fillon në datën 21.11.2013.
2. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Universitetit të Arteve i ngritur me Vendimin e Senatit Akademik nr. 3, datë 26.01.2012 dhe ndryshimet e mëvonshme, vazhdon funksionimin e tij edhe për zgjedhjet e pjesshme të datës 20.12.2013 në FAB.
3. Komisioni i Ankesave i Universitetit të Arteve i ngritur me Vendimin e Senatit Akademik nr. 5, datë 26.01.2012 dhe Vendimin nr. 6, datë 09.02.2012 vazhdon funksionimin e tij edhe për zgjedhjet e pjesshme të datës 20.12.2013 në FAB.
4. Komisioni i Zgjedhjeve të Fakultetit në FAB i ngritur me Vendimin e Senatit Akademik nr. 4, datë 26.01.2012 vazhdon funksionimin e tij edhe për zgjedhjet e pjesshme të datës 20.12.2013 në FAB.
5. Komisionet e zgjedhjeve të përcaktuar në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij vendimi fillojnë punën brenda dy ditëve nga miratimi i këtij Vendimi.
6. Regjistrimi i kandidatëve bëhet nga KQZI brenda një afati pesë ditorë nga fillimi i punës së KQZI, sipas kërkesave dhe në bazë të dokumentacionit të përcaktuar në Rregulloren e Zgjedhjeve.
7. Në Fakultetin e Arteve të Bukura hapet një qendër votimi, ku do të zhvillohet procesi zgjedhor për zgjedhjen e Përgjegjësve të Njësive Bazë.
8. Trupa zgjedhëse për përgjegjësin e një njësie bazë përbëhet nga personeli akademik i njësisë përkatëse, i cili është i punësuar me kohë të plotë.
9. Orari i votimit është nga ora 09.00 deri në orën 16.00 e datës 20.12.2013. Pavarësisht nga orari i përcaktuar, nëse KZF konstaton se përpara orarit të përcaktuar kanë votuar

Adresa: Blv. "Deshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri. Tel/Fax: +355 42 225 488, www.uart.edu.al  
të gjithë personat e listës së zgjedhësve, atëherë KZF mund të marrë vendim për mbylljen e procesit të votimit, pasi të ketë njoftuar më parë KQZI-në.

10. Për çështje të tjera të zhvillimit të zgjedhjeve të pjeshme të datës 20.12.2013 në FAB zbatohen dispozitat e përcaktuara në Rregulloren e Zgjedhjeve të UART (miratuar me VSA nr. 1, datë 17.01.2012 dhe VSA nr. 2, datë 26.01.2012).
11. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe shpallet publikisht.

**SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE**